



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 04/2009
Më 10.02.2009, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Sala Berisha – Shala, Berim Ramosaj, Kaqusha Jashari, Zef Morina dhe Mufëra Şinik.

Mungoi: Slobodan Petroviq.

Pjesëmarrës të tjerë: Remzije Hajdari (zyrtare në MTI), Mensur Azemi - ZMK, Blerina Uka - NDI, Isuf Zejna - KDI, Lejla Selimi – OSBE dhe Lumnije Berisha – Presidenca.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 03.02.2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve;
4. Shqyrtimi i Planit të punës për vitin 2009;
5. Të ndryshme.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 03. 02. 2009

Procesverbali i mbledhjes së 3 shkurt 2009 u miratua më vërejtjet e Safete Hadergjonajt dhe të Zef Morinës.

III. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve

Kryetarja – Kërkoj nga kryesuesi i Grupit të Punës për Shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve, z. Berim Ramosaj, të raportojë për këtë projektligj.

Berim Ramosaj – E paraqiti me shkrim raportin me 15 (pesëmbëdhjetë) amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve. Kërkoj nga Komisioni të miratohet me arsyetimin se këto amendamente të propozuara janë realizuar pas studimit të hollësishëm të projektligjit. Me këto amendamente do të plotësohej ky projektligj. Po ashtu z. Ramosaj e falënderoi posaçërisht stafin mbështetës, atë teknik dhe atë profesional, për bashkëpunim duke ofruar këshilla juridiko-ligjore dhe procedurale.

Safete Hadergjonaj – Kërkoj të evitohen vërejtjet që janë bërë në seancë plenare nga Komisioni për Integritet Evropian.

Sala Berisha – Shala – Bëri amendament në nenin 2 pika 9. Theksoi se duhet të shtohet thënia “shërbime ...” me të cilën do të plotësohej ajo: “mallra dhe shërbimet”. Më arsyetimin se ky ligj ka për qëllim ta mbrojë konsumatorin për mallra dhe shërbimet e ofruara.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

- I. Miratohen 15 amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve me vërejtjet e paraqitura.

IV. Shqyrtimi i Planit të punës për vitin 2009

Kryetarja – E falënderoi Grupin e Punës, në krye me z. Ethem Çeku, për përgatitjen e Planit të punës për vitin 2009. Njëherësh kërkoj nga deputetët të deklarohen a kanë diçka për të shtuar.

Ethem Çeku – Theksoi se Grupi i Punës është përpjekur që sa më mirë të hartohet plan i punës. I kërkoi edhe mendimet e të tjerëve lidhur më këtë çështje.

Zef Morina – Tha se Ligji për shpronësimin, edhe pse në plan është paraparë të miratohet në këtë muaj, ishte skeptik për zvarritjet e mëdha, sepse as në muajin mars nuk do të jetë gati. Njëkohësisht kërkoi t'i kushtohet vëmendje më e madhe këtij ligji, në mënyrë që sa më parë të miratohet.

Kryetarja – Shpjegoi se është njoftuar nga USAID-i, se po përfshihen vërejtjet e Bankës Botërore, të ICO-s dhe të MTPT-së. Drafti i fundit do të jetë gati javën e ardhshme, kurse Komisioni në fund të muajit shkurt do ta procedojë në seancë për miratim.

Safete Hadergjonaj – Kërkoi të përfshihet në Plan të punës “Shqyrtimi i raporteve të agjencive të pavarura”, që sipas ligjit përkatës e kanë për detyrë të raportojnë.

Sala Berisha – Shala – Tha se kemi lënë hapësirë për këtë çështje, por u pajtua që afatet të ceken saktësisht.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni e nxori këtë

Përfundim

I. Miratohet Plani i punës për vitin 2009 me vërejtjet e paraqitura.

V. Të ndryshme

V. a) Monitorimi i Ligjit nr. 2003/11 për rrugët

Kryetarja - I njoftoi anëtarët e Komisionit se Grupi i Punës për Monitorimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugët, më 11. 02. 2009, do ta bëjë një vizitë pune në Komunën e Prishtinës. Njëherësh e ftoi tërë Komisionin të marrë pjesë.

Zef Morina - Kryesues i Grupit të Punës për Monitorimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugët, tha se si Komision me ligj e kemi për detyrë ta mbikëqyrim zbatimin e ligjeve. Kërkoi nga deputetët ta kuptojnë mirë qëllimin e mbikëqyrjes. Theksoi se i vjen keq se disa zëra po qarkullojnë, gjoja se si pronar i një kompanie përfituese të Projektit të segmentit të ndërtimit të rrugës Fushë Kosovë – Sllatinë, nuk mund të jetë edhe udhëheqës i këtij grupi pune, për shkak të konfliktit të interesit. Sqaroi se Kompania e tij nuk është përfituese e këtij projekti, por një kompani kroate, me të cilën është kontraktues. Në fund z. Morina tha se nuk qëndrojnë pretendimet që po mbështeten padrejtësisht.

Kaqusha Jashari – Tha se Komisioni është duke e mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për rrugët, si p.sh. sinjalizimin, brezin rrugor, pikat e zeza etj., por jo cilësinë e asfaltit. Lidhur me këtë nuk sheh asgjë të keqe në këtë drejtim për pozicionin e z. Morina.

Berim Ramosaj – Tha se do të ishte parimore që z. Morina të tërhiqej nga kryesimi i këtij grupi pune, por jo edhe si anëtar i Grupit të Punës, sepse pozita e tij mund të reflektojë negativisht. Mund të dalë një “x kompani” dhe të thotë se deputeti Zef Morina, vetë e nxjerr ligjin për rrugët, vetë është pjesë e koalicionit, vetë është kontraktor dhe në fund vetë e mbikëqyr zbatimin e tij. Në fund kërkoi që z. Morina të largohet nga udhëheqja e Grupit të Punës dhe kjo çështje të diskutohet në rendin e ditës të mbledhjes së ardhshme, sepse në këtë çështje ka konflikt interesi.

Sala Berisha – Shala – Tha se mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve është detyrë ligjore e deputetit, por duhet ta marrim edhe si detyrë morale. Ajo sqaroi se si Komision po e mbikëqyrim zbatimin e ligjit e jo cilësinë e rrugëve. Kërkoi nga deputetët të kenë rezonim deputeti, jo t’i shohin gjërat vetëm zi, por të punohet në këtë frymë. Në fund tha se në kryesimin e Grupit të Punës prej z. Morina nuk sheh kurrfarë konflikti të interesit.

Safete Hadergjonaj – Kërkoi që kjo çështje të mos politizohet pa nevojë, sepse mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nuk ka për detyrë të merret më kontraktuesit, por me zbatimin e ligjit. Shtoi se Komisionit i duhet të dijë se çfarë rekomandimesh propozon ky grup pune në bazë të fakteve pas mbikëqyrjes, ndërsa me konflikt interesi le të merret ligji përkatës, jo ne këtu në Komision.

Haki Shatri – Tha se kjo çështje ka marrë përmasa mediave. Do të ishte në të mirë të deputetit, Zef Morina, të tërhiqet nga kryesimi i Grupit të Punës.

Ethem Çeku – Tha se Grupi i Punës në radhë të parë e ka për detyrë ta mbikëqyrë nivelin qeveritar, mirëpo nuk e përjashtoi edhe daljen në terren, në qoftë se ky grup e sheh të arsyeshme. Kërkoi që në këtë grup të jenë ata që e njohin legjislacionin e kësaj fushe.

Zef Morina – Duke replikuar, theksoi se sa i përket konfliktit të interesit nuk tërhiqet nga kryesimi i Grupit të Punës, sepse nuk ka konflikt të interesit, por, në qoftë se ka ndonjë fakt tjetër, mund të tërhiqet.

Kryetarja – Theksoi se Grupi i Punës dhe Komisioni duhet ta vazhdojnë punën. Kjo çështje nuk ka nevojë të zvarritet, por të vazhdohet mbikëqyrja. Po ashtu kërkoi që në takimin në komunën e Prishtinës Komisioni të jetë i plotë.

Pas këtij debati Komisioni e nxori këtë

Përfundim

- I. Të vazhdojë puna e Grupit të Punës për Monitorimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugët, sipas agjendës së paraparë.

V. b) Rekomandimi për Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë për zbatimin e Marrëveshjes së CEFTA-s

Kryetarja – E paraqiti rekomandimin e Grupit të Punës për Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë për zbatimin e Marrëveshjes së CEFTA-s dhe njëherësh hapi debat.

Pas debatit të gjerë të deputetëve: Berim Ramosaj, Zef Morina, Kaqusha Jashari, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj dhe Ethem Çeku, Komisioni e nxori këtë

Përfundim

- I. Republikës së Kosovës në vazhdimësi, nga disa vende të Evropës Qendrore – anëtare të Marrëveshjes së CEFTA-s, po i pamundësohet plasimi i mallrave të saj në këto vende, andaj;
- II. Duke u nisur nga fakti se Kosova tani është anëtare e barabartë dhe e përfaqësuar drejtpërsëdrejti në CEFTA, si edhe vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe;
- III. Duke e marrë parasysh faktin se Marrëveshja e CEFTA-s është dokument aktiv – pozitiv dhe i parespektueshëm për Republikën e Kosovës, nga disa anëtare (Serbia, Bosnja dhe Hercegovina etj.), shprehim pakënaqësi për mosqasje më aktive të Qeverisë (Ministrisë së Tregtisë e të Industrisë), përkatësisht për mos ndërmarrje të nismës së rishikimit të pozitës së Kosovës në këtë Marrëveshje.

Duke u mbështetur në këto fakte e vlerësime Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion e nxori këtë

Rekomandim

- U rekomandohet Qeverisë së Kosovës, Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë që të ndërmarrin urgjentisht veprime reciprociteti ndaj vendeve që nuk e respektojnë Marrëveshjen e CEFTA-s në raport me Republikën e Kosovës.

V.c) Organizimi i dëgjimit publik për Projektligjin për zonat ekonomike

Haki Shatri – Theksoi se si kryesues i Grupit të Punës është i gatshëm në kohën që e cakton Komisioni të organizojë dëgjim publik për Projektligjin për zonat ekonomike.

Pas diskutimeve të gjëra Komisioni e nxori këtë

Përfundim

- I. Më 25. 02. 2009, organizohet dëgjim publik për Projektligjin për zonat ekonomike.

V.d) Formimi i Grupit të Punës për Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave

Kryetarja – Kërkoi të konsolidohet Grupi i Punës për Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave.

Pas diskutimeve të gjëra Komisioni e nxori këtë

Përfundim

- I. Caktohet Grupi i Punës për Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave me këtë përbërje: Safete Hadergjonaj - raportuese, Myzejene Selmani dhe Zef Morina.

V.e) Çështjet vijuese

Safete Hadergjonaj – Kërkoi nga stafi mbështetës të bëjë kërkesë që anëtarët e Komisionit të pajisen më viza Schengen, në mënyrë që të jenë të gatshme për udhëtim jashtë vendit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Kryetare e Komisionit

Myzejene Selmani